



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 539/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2022:
 - Komunikacion dhe Transport, BSc 180 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik;
 - Komunikacion Rrugor, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme, BSc, 180 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik;
 - Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme, MSc, 120 ECTS, (me specializime ne: Termoenergjetika dhe Termoteknika; Sistemet e Burimeve të Ripërtritshme), maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS, (me specializime ne: Prodhimtari dhe Automatizim; Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti), maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike që deri më 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Komunikacion dhe Transport, BSc 180 ECTS, Komunikacion Rrugor, MSc, 120 ECTS, Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme, BSc, 180 ECTS, Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme, MSc, 120 ECTS, dhe Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Komunikacion dhe Transport	BSc	180	Ferat Shala, Azem Kycyku, dhe Sadullah Avdiu
2	Komunikacion Rrugor	MSc	120	Beqir Hamidi, Ilir Doci, dhe Naser Lajqi
3	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	BSc	180	Ali Muriqi, Rexhep Selimaj, dhe Xhevat Berisha
4	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	MSc	120	Fejzullah Krasniqi, Naser Sahiti, dhe Bedri Dragusha
5	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment	MSc	120	Agron Pajaziti, Gani Pllana, dhe Fitore Mustafa Abdullahu

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike më 22.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Tauno Otto, Herwig Grogger dhe Andreas Mehrle.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë